

VENDIM
Nr.53, datë 16.1.2008

**PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN E
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME,
NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE
INSTITUCIONEVE TË VARËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b” të pikës 2 të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Ministrisë së Brendshme, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë e të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, të ministrive e institucioneve, në varësi të ministrisë/ministrit, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve të poshtëshënuara:

- a) furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje;
- b) shërbimet e komunikimit me internet dhe e-mail (abonime të reja);
- c) blerjen e autoveturave për funksionarët e lartë të shtetit ose për nevojat e institucioneve;
- ç) blerjen e kompjuterave dhe të makinave të shumëfishimit;
- d) blerjen e mallrave e të produkteve të kancelerisë;
- dh) shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike me subjekte private të ndërtesave të ministrive.

2. Ministria e Brendshme të prokurojë fondin limit, të llogaritur si shumë të fondeve buxhetore, të miratuara për çdo institucion, për secilin nga mallrat dhe shërbimet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Autoritetet kontraktuese, institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, brenda datës 31 janar, të dërgojnë në Ministrinë e Brendshme, si organi qendror blerës, të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës, për çdo prokurim.

4. Ministria e Brendshme, brenda datës 15 shkurt, të shpallë ftesën për ofertë.

5. Ngarkohen Agjencia e Prokurimit Publik të udhëzojë autoritetet kontraktuese për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohet Ministria e Brendshme dhe institucionet e përmendura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha